

Organizata për Fëmijët pa kujdes Prindëror- OFAP:


OFAP është shoqatë kombëtare humanitare, që ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror në Kosovë. Misioni i organizatës është që çdo fëmije të braktisur dhe pa kujdes prindëror t'i ofrohet një familje e përkohshme që të jetojë, të rritet, të ndjehet pjesë e saj, dhe të ketë dashurinë që i nevojitet. OJQ OFAP ofron mbështetje psikosociale për familjet dhe fëmijët e ri-atdhesuar të ekspozuara ndaj migracionit të pasigurt, dhe formave të ndryshme të dhunës.



“TË MBËSHTESIM SË BASHKU FAMILJET/PERSONAT E RIATDHESUAR NË KOSOVË”

Për më shumë informata kontaktoni
Zyren për Kthim dhe Komunitete në komunën tuaj dhe
Organizatën për Fëmijët pa kujdes Prindëror-OFAP
Email: Ofap.kosova@hotmail.com; info@ofap.org
Tel: +383 (38) 613 888
Web: www.ofap.org

Implementuar nga:



Facebook: OFAP Kosova, Organizata për fëmijët pa kujdes prindëror



Paketa e ndihmës sipas rregullores për të riatdhesuarit përfshin:

- Banim përmes qirasë
- Pakon e ndihmesës për dimër
- Trajtim mjekësor
- Rindërtimin, rinovimin e shtëpive
- Pako të orendive shtëpiake
- Ndhmën dhe mbështetjen për personat e cënueshëm
- Plan Biznesi (trajnimet e ofruara nga Qendra e Aftësimit profesional, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Entit për Punësim)

KU DUHET TË ORIENTOHEN PERSONAT E RIATDHESUAR PËR INFORMATA DHE NDIHMA EMERGJENTE:

Personat e riatdhesuar duhet të orientohen te Zyra Komunale për Kthim dhe Komunitete në nivel lokal – e cila ka këto përgjegjësi:

- Të ndihmojë me këshilla personat e riatdhesuar për mundësinë e përfitimit nga skemat e Riintegritimit, dhe për plotësimin e kërkesave.
- Të pranojë kërkesat e të riatdhesuarve.
- Të vlerësojë nevojat fillestare të të riatdhesuarve.
- Të mbështesë/mbikqyrë riintegrimin në bashkëpunim me institucionet tjera.
- Të udhëzojë personat e riatdhesuar për shërbimet që ofrohen në nivel komunal.
- T'i pajisë personat e riatdhesuar me vërtetim të riatdhesimit.

